

PROÇESVERBAL I PLANIT LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË

Datë 25 gusht 2025 ora 14:00

Salla e Këshillit Bashkiak

KëSHILLTARE E.Mitre: Përshendetje, mirë se keni ardhur, ju falenderoj për prezencën tuaj në emër të kryesisë të Këshillit bashkiak. Sot u bënë disa diskutime, konsultime publike, ky është i fundit, por salla është më e bukur me prezencën tuaj. Dejvi do prezantojë planin dhe më pas ju keni pyetjet dhe sygjerimet tuaja.

Dejvi Hoxha: Përshëndetje, faleminderit që keni erdhur plani për rininë është hartuar nga Bashkia Korçë, Qendra e të Drejtave për Fëmijët në Shqipëri, është mbështetur nga Agjensia Kombëtare për rininë dhe Ministri i Shtetit për fëmijët dhe të rinjtë. Sfidat që kemi hasur është pa punësia dhe mungesa sipërmarrëse, pjesëmarrja e ulët politike dhe dhe vendimmarrëse, gjithashtu infrastruktura arsimore e pa mjaftueshme, shërbime sociale dhe shëndetësore të kufizuara. Misioni i këtij plani-veprimi është përmirësimi i gjëndjes ekonomike, arsimore, sociale, dhe fuqëzimi i të rinjve që jetojnë dhe punojnë pranë Bashkisë Korçë. Ky plan është krijuar mbi bazën e 5 prioriteteve strategjike mbi të cilat është punuar mbi pika kryesore. Punësimi dhe pjesëmarrja rinore, pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor, arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, shërbime sociale dhe cilësore dhe mbështetja e organizatave rinore. Të rinjtë e Korçës duhet të kenë mundësi punësimi për të zhvilluar sipërmarrjet e tyre ndaj 5 pikat kryesore të këtij plani, skema e punësimit sezonal, praktikat profesionale dhe lidhje me tregun e punës, mbështetje për startape rinore dhe nisma innovative, trajnime për aftësi profesionale dhe dixhitale dhe gjithashtu panairë pune dhe nxitje e turizmit rinor. Zëri i të rinjve duhet të dëgjohet dhe të ketë fuqi për vendimmarrje. Besoj se tani jemi të hapur të diskutojmë do ishte shumë me vlerë të dëgjoja mendimet tuaja dhe shtesat që mund të kemi, sepse normalisht ky nuk është një plan perfekt, kush do mund të marrë fjalën.

KëSHILLTARE E.Mitre: Ka pyetje?

Aida Shkodrani: Fillimisht urime për detyrën e re, unë kam një pyetje më shumë nga ana e kuriozitetit tim personal sesa me planin. Për çdo shtyllë pashë se keni nxjerrë disa pika kryesore, jam tek punësimi dhe sipërmarrja, pyetja ime është për secilën nga këto pika keni bërë një plan veprimi individual për të aritur realizmin e këtyre pikave?

Dejvi Hoxha: Kjo është planifikuar edhe tek matrica, në fund të planit të veprimit janë matricat që do thotë janë gjithë aktivitetet që ne kemi hartuar dhe kur kemi folur me Kryetarin e Bashkisë duke ofruar sesi Bashkia bashkë me bizneset duhet të lidhe marrëveshje bashkëpunimi me bizneset për praktikën në Bashki sesi të jetë më funksionale.

Këshilltar K.Pllaha: Unë kem edhe rastin për të diskutuar në mbledhje, por meqënëse jemi në konsultim publik pse mos bëjmë pyetje. Pashë se puna e kësaj ka nisur nga nëntori 2023 deri në dhjetor 2024 , pse keni pritur deri tani për të bërë konsultimin publik?

Joan Deli: Nuk ka pasur forum rinor, dhe Qendra Rinore ishte në rikonstrukcion.

Këshilltar K.Pllaha: Kush ka qënë grupi që e ka hartuar?

Joan Deli: Ka qënë CRCA bashkë me pjesën e Akr dhe Bashkisë.

Këshilltar K.Pllaha: Agjensia Kombëtare e Rinisë dhe Qendra për të Drejtat e Fëmijëve, në aspektin lokal?

Joan Deli: Në pjesën e workshopit kanë erdhur nga Tirana, pjesë e organiztaës, ka qënë Kvr pjesë e takimeve, ka pasur dhe këshilltarë në takime ku janë diskutuar çështje thelbësore se çfarë do përmbante plani.

Këshilltar K.Pllaha: Cili është roli i Bashkisë?

Joan Deli: Ata e sollën planin, për studim të mëtejshëm për shumë kohë, Këshilli Vendor Rinor ka qënë pjesë e hartimit.

Këshilltar K.Pllaha: Këshilli Vendor Rinor nuk mund ta bënte konsultimin më parë që ato ide që të dilnin gjatë konsultimit për tu përpunuar dhe për tu futur në Këshill.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ne si Këshill na vjen një draft pastaj e vendosim nëse bëhet konsultimi publik apo jo, pra konsultimi bëhet mbi bazën e një drafti.

Këshilltar K.Pllaha: Kur ka erdhur drafti?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Drafti ka erdhur në datën 1 dhe njoftimi është bërë në datën 2.

Entela Maçka : Me sa kam lexuar Crca ka bërë konsultime me fokus grupe.

Këshilltar K.Pllaha: Nëse tek ky konsultim do dalin Kritika, do dalin mendime si do veprohet sepse 3 ditë kohë ke, ne na vjen për miratim të enjte.

Këshilltar E.Mitre: Do shtohen.

Këshilltar K.Pllaha: Duhet një draft paraprak para se të vijë për miratim.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Prandaj bëhen dëgjesa dhe sygjerimet që bëhen ja dërgojmë ekzekutivit dhe kryetari i Bashkisë na thotë se çfarë do vendoset apo jo.

Këshilltar K.Pllaha: Dalin tre ditë?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Po dalin sepse nesër në mëngjes do jenë në kryetari.

Këshilltar E.Mitre: Përderisa do miratohet ditën e premte do miratohet me ndryshimet përkatëse.

Këshilltar K.Pllaha: Pashë procesin e krijimit të planit dhe ishte ndarë në 6 etapa dhe etapa e 4 dhe e 5 ishte shënuar sikur ishte bërë apo do bëhet?

Ishte thënë që ishte bërë konsultimi janë marrë në konsideratë kërkesat e qytetarëve dhe janë paraqitur për shqyrtim.

Dejvi Hoxha: Me rrjedhë logjike do miratohet.

Këshilltar K.Pllaha: Kjo qëndra e shërbimeve rinore me një ndalesë ku është pozicionuar se unë nuk e kam idenë?

Qytetaria: Tek Klinika Kristi në krahun e majtë, tek kopështi.

Këshilltar K.Pllaha: Ka ndonjë tregues sasior, sa të rinj e kanë frekuentuar?

Qytetaria: Statistikat nuk i kam, i ka qendra, mund të them numrin e aktiviteteve.

Këshilltar K.Pllaha: Nesër kemi mbledhjen e komisioneve, nëse mund të na i sillni do ishte mirë. Ka pasur një plan rinor 2019-2023, a ka tregues të matshëm sa është realizuar.

Joan Deli: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar K.Pllaha: Po nuk vure indikatorë të matshëm nuk mund të themi se ky plan është realizuar mirë apo jo. Është plan strategjik, duhet të jetë i detajuar, përshembull do punësojmë të rinj, si përshembull, duhet të shikoni sa janë të rinj të papunë, problematikat dhe në bazë të tyre ngre një strategji, unë do sygjeroja të sillni indikatorë të matshëm, sa është numri i të rinjve çdo ditë me etapa, që ndihmojmë në punësim. Pastaj si do ja u mbushësh mendjen bizneseve çfarë ju ofron?

Megi Koleci: Kemi marrë disa nisma, kemi folur me bizneset për t'i punësuar, në fushën e inovacionit.

Këshilltar K.Pllaha: Në fusha të tjera si e incentivoni ju punësimin e të rinjve?

Joan Deli: (Nuk ka audio.)

Këshilltar K.Pllaha: Mund të ketë dhe sygjerime të tjera, mund të mbulojë Bashkia Korçë sigurimet të të rinjve që punësohen për herë të parë, për një afat kohor përshembull 6 muaj, unë po jap një sygjerim le ta shohë Drejtoria e Financës.

Dejvi Hoxha: E kërkon ligji i ri, që të ketë një buxhet të parashikuar për të rinjtë.

Këshilltar K.Pllaha: Ju e keni nxjerrë një buxhet sepse do vini para kryetarit.

Dejvi Hoxha: Nuk mund të nxjerrësh një buxhet pa parë efektet negative dhe pozitive.

Megi Koleci: Bashkia ka programe të ndryshme, (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Dejvi Hoxha: Tani që do i rritet numri do jetë më aktiv Klajdi.

Këshilltar K.Pllaha: Të rinjtë që lexojnë këtë plan krijojnë pritshmëri shumë të mëdha dhe nëse ti ja u cënon ata zhgënjehen edhe ikin nga Korça.

Këshilltar E.Mitre: Nuk kanë pse t'ja u cënojnë Klajdi për këtë po përpiqen edhe këta.

Aida Shkodrani: Të rinjtë duhet të përpiqen edhe vetë, sepse studentët që vijnë bëjnë praktikën në Bashkinë Korçë, niveli i tyre lë shumë për të dëshiruar, unë nuk punoj dot 8 me 1 në Bashki sepse jam në punë thot ajo.

Entela Maçka: Jam Entela Maçka drejtuese e shoqatës “Gruaja në zhvillim Korçë”, unë e kam lexuar dokumentin dhe kam erdhur me disa pika konkrete, më duket se do përsërit idetë e mia sepse këto pika i kemi trajtuar ditën e rinisë me anëtarët e Këshillit Rinor ku ishte prezent dhe kryetari i Bashkisë. Tek prioriteti 1 i jam referuar më tepër matricës, sepse tek kjo matricë është ajo që tha dhe Klajdi që nuk është vetëm objekti por dhe cilët janë idnikatorët matës, ndoshta më shumë konkret ato indikatorët por ekzistojnë tek matrica. Prioriteti i parë punësimi dhe sipërmarrja rinore, tek ky dokument bizneseve ju ofrojnë lehtësi fiskale për punësimin e të rinjve, unë këtu do propozoja që këto biznese jo vetëm ti punësonin por të ofronin dhe intership për këta të rinj, e diskutuam dhe vetë kryetari tha të bëjmë konsultime me bizneset dhe jo vetëm intership pranë bizneseve por edhe pranë institucioneve të ndryshme, Në kuadër të rrjetit Pop kemi organizuar takime me focus grupe me qytetarë me të rinj dhe këto janë propozime që kanë dale nga këto grupe. Një problem tjetër na kanë kërkuar edhe kurse të avancuara për teknologjinë e informacionit, si të menaxhojnë mediat sociale dhe i kanë kërkuar falas dhe e diskutuam me kryetarin, ndoshta mund të bëjmë një kategorizim siç tha dhe kryetari sepse ka vërtet studentë që nuk kanë mundësi ekonomike të mira dhe t’ju krijohen kushte për të zhvilluar kurse falas.

KëSHILLTARE E.Mitre: Në konsultimin e parë që bëmë për barazinë gjinore, është një grup nga komunitetet që marrin falas trajnimin.

Entela Maçka: Kur bëhet fjalë për një plan në makro atje janë të përcaktuara indikatorët, dhe mund të vihej një % të paktën , duhet të jenë të përcaktuar sepse këto indikatorë shërbejnë si matje të asaj që është realizuar. Mund të përcaktohet një % e caktuar që nga këto kushte kaq % mund t’ju ofrohet mundësia për t’i marrë falas këto kurse dhe organizmi i panairëve të karrierës ndoshta mund të shtohet tek matrica. Ai ai prioritet që kam me merak, do vija theksin tek fuqëzimi i Këshillit Rinor Vendor, e kemi thënë edhe me Joanin që ky nivel ka funksionuar më shumë në nivel konsultues e mira është të forcohet si organizëm në mënyrë të tillë që të krijojë praktika pozitive, të marrin iniciativa qytetare për zgjidhjen e probelmeve të ndryshme, duhet të punohet sepse Këshilli Rinor hyn në mekanizma komunitare që janë shumë të rëndësishme përse i përket rolit të tyre në komunitet dhe për këtë unë kam bërë diçka, siç ishin matricat dhe ja u kam nisur të gjithë atyre që ishin të gjithë të pranishëm do ja u nis dhe ju tek adresat përkatëse dhe ato që ju i shihni të arsyeshme dhe mund t’i futni, unë po e dërgoj më të detajuar. Tek Këshilli Rinor kam parë të arsyeshme rritjen e kapaciteteve të anëtarëve që duhet të trajnohen dhe pastaj të kalojnë nga teoria në praktikë, i kem vendosur dhe indikatorët. Këto janë problematikat që kanë dalë nga focus grupet.

KëSHILLTARE E.Mitre: U fol për kujdesin shëndetsor, është parashikuar këtu një trajtim enkas për të rinjtë që janë përdorues të lëndëve narkotike, mund të vendoset një qëndër atje për një trajtim më të specializuar për këta të rinj.

Dejvi Hoxha: Patjetër shumë me vlerë kjo që sapo thatë, nuk është parashikuar, është parashikuar pjesa e ndërgjegjësimit për fushatë për personat me probleme të shëndetit mendor.

KëSHILLTARE E.Mitre: Edhe diçka për strehimin e të rinjve, sa mendohet të parashikohet interesi i kredisë apo qirasë që do marrin për të jetuar?

Programet sociale të Bashkisë janë lehtësuese deri në 3% interesi i kredisë, pastaj ato të qirasë janë tjetër gjë, mendohet të kërkohet një ulje për të rinjtë?

Dejvi Hoxha: Kjo pjesë i takon drejtorive përkatëse por edhe ligjit sepse mesa di unë nga eksperiencia e mëparshme e Këshillit bashkiak di që ka disa kritere që i përcakton ligji nuk e di sa hyjnë të rinjtë.

KëSHILLTARE E.Mitre: Ka ndonjë pyetje tjetër?

Stela Viso: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Dejvi Hoxha: Kryesorja është se Këshilli rinor vendor e ka me detyrim të takohet njëherë në muaj, gjithashtu edhe për menaxhimin e Qendrës Rinore kemi menduar të krijojmë një këshill tonin jo legjislativ. E cakton ligji që duhet të takohet njëherë në muaj. Kam qënë kryetari i Këshillit Studentor për pjesën e Fakultetit Ekonomik dhe për çdo aktivitetet që bënim dhe pjesëmarrja sihte shumë e ulët. Aktivitetet e tjera ndikuese nuk ka asnjë dhe besoj se pas protestave të studentëve pati një ndikim pozitiv në rritjen e vëmendjes për Këshillin Studentor dhe nuk kishte asnjë indikator që studentët të nxirnin projekte dhe ide interesante dhe këtë e them me shumë keqardhje.

Entela Maçka: Dejvi kjo është e vërtetë por ne diskutam edhe këtë do bëjmë trajnimet, bëjmë një kombinim trjanim-zbavitje vetëm kështu mund t'i tërheqim të rinjtë sepse kështu funksion edhe në mësimdhënie.

Përfaqësuese e Organizatës World Vision: Përsëritet jam Eleni përfaqësoj Organizatën World Vision këtu në Korçë edhe Këshillin Rinor, një sygjërim në lidhje me prioritetin nr.3 arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, fuqëzimi pak më tepër i këshillimit të karrierës për të rinjtë, orientimi drejt zgjedhjes të profesionit dhe diçka tjetër që ngelet tek takimi, takimet ndërgjegjëse le të themi të jenë pak më të qëllimshme, më të shpeshta për ta lidhur pak edhe me planin social të barazisë gjinore, situata kohët e fundit na tregojnë se ka mungesë ndërgjegjësimi tek të rinjtë, fillo që nga fjalori i përdorur, që nga problemet sociale kështu që këto takime të ishin më të shpeshta.

Këshilltar K.Pllaha: Një korrigjim, është përmendur në plan se janë 6 prioritetet në fakt lexoj vetëm 5, mund të jetë lapsus.

KëSHILLTARE E.Mitre: Nëse nuk kemi diçka tjetër e mbyllim. Dejvi suksese në punën e re, suksese gjithë ekipit, ju falenderoj për pjesëmarrjen, kalofshi mirë!

Sekretari i Këshillit

Eva Naçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Listëprezenca e konsultimit

“PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË KORÇË (2025-2028)”

Takim datë 25.08.2025 ORA 14:00

NR.	EMËR, MBIEMËR	E-MAIL	NËNSHKRIMI
	Xheni Bimbli	zhgaba.x@gmail.com	
	Gjona Spahillari	gjona.spahillari@gmail.com	
	Joana Teneqexhi	joana.teneqexhi23@gmail.com	
	Stela Viso	stela-viso@gmail.com	
	Eni Joco	eni.joco@yahoo.com	
	Joan Deli	joan.deli@yahoo.com	
	Ralfi Vaso	ralfi.vaso@gmail.com	
	Arde Kusto	ardeshkodra@gmail.com	
	Megi Kuleci	megi-kuleci@hotmail.com	
	Sami Kuleci	sami.kuleci@yahoo.com	
	Klajdi Pllaha	kplaha@yahoo.com	
	Besmira Zirelli	besmira.zirelli@hotmail.com	
	Bukla Macka	wiolkentek@yahoo.it	
	Denada Tabaku	denada.tabaku@bashiaekorce.gov.al	
	Edlira Mitre	edlira.mitre@yahoo.com	

[illegible]

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Eva NAÇI







Bashkia Korçë përfshin 8 njësi administrative:

- Korçë
- Qendër Korçë (Balgarec)
- Vinkaj
- Vinkopoll
- Lesh
- Vithkaj
- Molliq
- Drenovë

Ajo përbën një ndihuesje të zonave urbane dhe rurale, që që ndihon ndjeshëm në mirëmbajtje e organizimin e shërbimeve publike dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Prenja e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësi administrative krijon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimin për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të shërbimeve të shëndetit në të gjithë territorin e Bashkisë.

